



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS



COMUNE DI GIOIA DEL COLLE

**MARËVESHJE BASHKËPUNIMI MIDIS
UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS
DHE
KOMUNËS GIOIA DEL COLLE**

Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Komuna e Gioia dell Colle më poshtë të quajtura palët, mbështetur te kërkesa për partneritet e ardhur me email nga Kyetari i Komunës së Gioia dell Colle, në datë 19.08.2024, për të marrë pjesë në thirrjen e Rajonit të Puglias me emërtimin “L.R. 20/2003 “Partenariato per la Cooperazione” - D.G.R. n. 1113 del 31/07/2024 “Linee d’indirizzo per la predisposizione dell’avviso pubblico 2024” - Approvazione e emanazione Avviso Pubblico 2024 “Invito a presentare proposte progettuali” per la concessione di contributi (Allegati A e B) e approvazione modulistica. (N. 00228 del 02/08/2024 del Registro delle Determinazioni della AOO 144 Dipartimento Sviluppo Economico - Sez. Relazioni Internazionali); me projektin me titull “PROspettive di Filiere casearie ad ImpaTto 0 - "PROFIT 0", të cilit i është caktuar kodi CUP: B64H24001170003, pas pranimit të projektit për financim

Palët bien dakort përsa vijon:

Neni 1

Partneritetin në projekt propozimin me titull: “PROspettive di Filiere casearie ad ImpaTto 0 - "PROFIT 0", me jetëgjatësi prej 12 muajsh nga momenti i pranimit për financim. Projektit i është caktuar kodi CUP: B64H24001170003.

Neni 2

Në veçanti bashkëpunimi do të jetë i fokusuar në kryerjen e aktiviteteve dhe arritjen e objektivave nga ana e të dyja palëve të aktiviteteve 1, 2 dhe 3.

Neni 3

Pjesëmarrja në aplikimin për thirrje nuk përfshin asnjë detyrim financiar.

Neni 4

Universiteti Bujqësor i Tiranës, në cilësinë e partnerit në projekt, do të ofrojë mbështetje në këtë iniciativë në terma të përdorimit të ambienteve shkollore, hapësirave laboratorike, zonave bujqësore për zhvillimin e aktiviteteve të projektit si dhe me burime njerëzore.

Neni 5

Pjesëmarrja monetare e institucionit tonë do të realizohet duke vënë në dispozicion burimet njerëzore të veta (2 punonjës të Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit), për të punuar në arritjen dhe zhvillimin e pikave të përmendura në nenin 3 me një total vetfinansimi prej € 2.000,00 (dymijë euro/00). Ky vetfinansim do të llogaritet bazuar te pagat mujore të personelit të angazhuar.

Neni 6

Komuna e Gioia dell Colle, në cilësinë e drejtuesit të projektit, do të ofrojë dhe vërë në dispozicion fondet e nevojshme për realizimin e qëllimeve dhe objektivave të projektit. Këto fonde përfshijnë zërat e mëposhtëm:

1. Për shërbime logjistike në funksion të arritjes së objektivave të aktivitetit 1, fondi në dispozicion për Universitetin Bujqësor të Tiranës është në vlerën totale prej € 1.730,00 (njëmijë e shtatëqind e tridhjetë euro/00).
2. Inovacion në teknologji, në funksion të arritjes së objektivave të aktivitetit 1, fondi në dispozicion për Universitetin Bujqësor të Tiranës është në vlerën totale prej € 1.770,00 (njëmijë e shtatëqind e shtatëdhjetë euro/00).
3. Për promocion dhe publicitet të projektit, fondi në dispozicion për Universitetin Bujqësor të Tiranës është në vlerën totale prej € 700,00 (shtatëqind euro/00).
4. Pagesa për personelin, 2 persona të angazhuar nga Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit, në funksion të arritjes së objektivave të aktiviteteve 1, 2 dhe 3, fondi në dispozicion për Universitetin Bujqësor të Tiranës është në vlerën totale prej € 2.750,00 (dymijë e shtatëqind e pesëdhjetë euro/00), ndarë përkatësisht në € 1.000,00 (njëmijë euro/00) për aktivitetin 1, € 750,00 (shtatëqind e pesëdhjetë euro/00) për aktivitetin 2, dhe € 1.000,00 (njëmijë euro/00) për aktivitetin 3.

Neni 7

Palët bien dakort që kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është dokument bazë dhe për ndryshimet, plotësimet e saj si dhe për marrëveshjet e tjera specifike të arritura ndërmjet palëve do të bëhen diskutime paraprake. Çdo nen i kësaj Marrëveshjeje mund të ndryshohet ose revokohet në çdo kohë pas konsultimit dhe mirëkuptimit reciprok midis palëve.

Neni 8

Palët kanë detyrimin të sillen me korrektësi kundrejt njëra- tjetrës. Kjo nënkupton përveç të tjerave që palët, gjatë përmbushjes së detyrimeve të tyre reciproke dhe ushtrimit të veprimtarisë së tyre, të mos çenojnë interesat e njëra- tjetrës. Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.

Neni 9

Kjo Marrëveshje nënshkruhet në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, dy për secilën Palë, me vlerë të barabartë, dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit.

KOMUNA E GIOIA DEL COLLE

Kryetari

Avv. Giovanni MASTRANGELO



IL SINDACO
Avv. Giovanni Mastrangelo

UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

Rektori

Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU

